



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Nr. 4864 Prot.

Tiranë më, 27 / 2 /2020

UDHËZIM

Nr. 2 datë 27 / 2 /2020

**Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 01, datë 03.01.2018 “Mbi operacionet e privilegjuara”**

Në zbatim të nenit 184, të ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Për Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, nenit 398 dhe 737 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 651, datë 10.11.2017 “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në Udhëzimin nr.1, datë 03.01.2018 “Mbi operacionet e privilegjuara”, pika 13, ndryshon me përmbajtjen si më poshtë vijon:

**“13) Mallra që importohen nga Forcat e Armatosura dhe Policia e Shtetit**

**Baza Ligjore:** Shkronja “n”, e pikës 3, të nenit 184, të ligjit nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;  
Shkronja “ç”, e nenit 486, të VKM nr.651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;  
Pika 43, e nenit 56, të ligjit 92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**Përfitues:** Ministria e Mbrojtjes, Forcat e Armatosura dhe Policia e Shtetit

**Procedura:** Me autorizim të Kryetarit të Degës Doganore

**Objekti i**

**Përfashtimit:** Në rast të Marrëveshjeve të ratifikuara nga Kuvendi, nuk ka kufizime për përjashtimin nga taksa doganore të mallrave, mjafton që të importohen në kuadër të marrëveshjes.

Nëse importi është sipas nenit 184, pika 3 (n), të Kodit Doganor, mallrat që përfitojnë përjashtim nga taksa doganore janë: instrumente, aparate dhe pjesët e tyre, veshmbathje si dhe materialet logjistike, shëndetësore, makineri dhe pajisje.

Mallrat dhe pajisjet për qëllime ushtarake dhe që përdoren si armë, municion apo bazë materiale luftarake dhe të cilat janë projektuar, zhvilluar, prodhuar,

montuar apo modifikuar për përdorim ushtarak, që importohen në emër të Ministrisë së Mbrojtjes, sipas pikës 43, të nenit 56, të ligjit 92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar përfitojnë përjashtim nga TVSH.

**Dokumente:** Kërkesa për përjashtim, akti i dhurimit ose jo, për mallrat e importuara, dokumentacioni i importit.

**Kodi i Procedurës Shtesë, kutia 37.b (DAV):**

- **512** Përjashtim vetëm nga taksa doganore, (i zbatueshëm për Forcat e Armatosura dhe Policinë e Shtetit);
- **520** Përjashtim nga taksa doganore dhe TVSH (i zbatueshëm për Ministrinë e Mbrojtjes);
- **521** Përjashtim vetëm nga TVSH (i zbatueshëm për Ministrinë e Mbrojtjes)”

Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit, të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Gjon Bardhi**

